



**Republika e Kosovës – Republika Kosova**  
**Paneli Zgjedhor për Ankesa dhe Parashtresa**  
**Izborni Panel za Žalbe i Predstavke**

**Anr.357/2019**

**Paneli Zgjedhor për Ankesa dhe Parashtresa (PZAP)**, në panelin e përbërë nga gjyqtarët: Faton Ademi kryesues, Fejzullah Rexhepi dhe Adnan Konushevci anëtarë, me pjesëmarrjen e zyrtares ligjore Fatjona Bekteshi, duke vendosur përkitazi me ankesën e subjektit politik Partia Demokratike e Ashkalinjëve të Kosovës (PDAK), e paraqitur kundër Komisionit Qendror të Zgjedhjeve (KQZ), për shkak të gabimit teknik në Formularin e Përputhjes së të Dhënave dhe Rezultateve (FPR), dhe ndikimit të rezultati i publikuar, për Zgjedhjet e Parakohshme për Kuvendin e Republikës së Kosovës, të datës 06.10.2019, në seancën e panelit të mbajtur më datë 10.10.2019, mori këtë:

## **V E N D I M**

**HUDHET** e pa lejuar ankesa Anr.357/2019 e datës 08.10.2019, e paraqitur nga subjekti politik Partia Demokratike e Ashkalinjëve të Kosovës (PDAK), me të cilën ka kërkuar që të Urdhërohet KQZ-ja, të bëjë rinumërimin e fletëvotimeve në këto Komuna: Glllogoc, Gjilan, Dragash, Kaçanik, Kamenicë, Mitrovicë e Jugut, Lipjan, Podujevë, Prishtinë, Skenderaj, Shtime, Suharekë, Ferizaj, Viti, Vushtri, Malishevë, Klllokot, Drenas, Deqan, Gjakovë.

## **A r s y e t i m**

Me datë 08.10.2019, PZAP-i, ka pranuar ankesën Anr.357/2019, e paraqitur nga subjekti politike Partia Demokratike e Ashkalinjëve të Kosovës (PDAK), e paraqitur ndaj KQZ-së, me të cilën pretendon se sipas rezultateve preliminare dyshojmë se në 20 komuna të Republikës së Kosovës, votat e subjektit politik PDK kanë kaluar në subjekte tjera, në subjektin PLE dhe PAI, rezultat ky i cili dëmton rëndë subjektin politik PDAK sepse i pamundëson hyrjen në Kuvend të Kosovës. Dhe kështu me anë të kësaj ankese kërkojmë që në këto komuna: Glllogoc, Gjilan, Dragash, Kaçanik, Kamenicë, Mitrovicë e Jugut, Lipjan, Podujevë, Prishtinë, Skenderaj, Shtime, Suharekë, Ferizaj, Viti, Vushtri, Malishevë, Klllokot, Drenas, Deqan, Gjakovë, të bëhet rinumërimi i fletëvotimeve dhe të evidentohet çdo votë, në këtë mënyrë të përmirsohet çdo manipulim i mundshëm.

Paraqitësi i ankesës, për të vërtetuar pretendimet e tyre, ankesës i ka bashkangjitur disa përfundime të nxjerra nga ky subjekt, të shkruara me dorë të lirë lidhur me votat kontestuese të subjektit PLE, nëpër komunat e lartë cekura.

Paneli, pas shqyrtimit paraprak të lejueshmërisë së ankesës gjeti se:

**Ankesa është e palejuar**

Paneli vlerëson se pretendimi i palës ankuese edhe pse i referohet parregullsive në ditën e votimit, respektivisht gabimit teknik në Formularet e Perputhjes së Rezultatave, për shkak se përmes kësaj ankese atakohet rezultati i cili është ende si rezultat preliminar, e i cili rezultat mund të ndryshoj, ankesa në këtë fazë të procesit zgjedhor është e parakohshme, për shkak se pas publikimit të rezultatit përfundimtar i njëjti rezultat është i ankimueshëm nga subjektet politike edhe kandidatët të cilët kanë pretendime në raport me numrin e votave të tyre. Meqenëse në aspektin kohor-faza e procesit zgjedhor kur parashtrahet ankesa është e parakohshme ankesa duhet të hudhet poshtë e palejueshme.

Në momentin e publikimit të rezultatit përfundimtar nga KQZ-ja, palët e pakënaqura në pajtim me nenin 105 të Ligjit për Zgjedhjet e Përgjithshme, mund të ushtroj ankesën në afatin prej 24 orëve.

Bazuar në arsyet e sipërshënuara dhe në kuptim të nenit 118.1 të LZP-së i cili parasheh se “PZAP-i, pranon ankesat e bazuara në fakte dhe refuzon ankesat të cilat nuk i përmbushin standardet” dhe Nenit 6.4 të Rregullave dhe Procedurave të PZAP-it, në të cilin përcaktohet se: “Ankesat të cilat janë të palejuar dhe të pasafatshme PZAP-i i hudhë poshtë me vendim”, lidhur me ankesën e lartë përmendur vendosi si në dispozitiv të këtij vendimi.

Vendosja sikurse në dispozitiv të këtij aktvendimi për hudhjen e ankesës të palejueshme nuk e prejjudikon rezultatin përfundimtar e po ashtu me të njëjtat pretendime ankimore palët mund ta atakojnë/apelojnë rezultatin përfundimtar.

Prandaj, nga arsyet e theksuara më lartë, e në kuptim të nenit 118.1 të LZP-së dhe nenit 6.4 të Rregullave dhe Procedurave të PZAP-it, Paneli vendosi si në dispozitiv të këtij vendimi paneli vendosi si në dispozitiv të këtij vendimi.

**Paneli Zgjedhor për Ankesa dhe Parashtrësia**  
**A nr. 357/2019 më datë 10.10.2019**



**Këshillë juridike:** *Kundër këtij vendimi nuk është e lejuar ankesa.*